



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 196

Tiranë – E Premte, 26 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 889, datë 17.12.2014	Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2014.... 11003
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 364, datë 16.12.2014	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore..... 11006
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 29, datë 18.12.2014	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive..... 11009
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 30, datë 23.12.2014	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit..... 11012
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 38/1, datë 10.12.2014	Për një ndryshim në urdhrin nr. 38, datë 28.1.2014 “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme”..... 11025
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit nr. 5339/4, datë 4.12.2014	Për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projekteve “Rivitalizimi i Qendrës së Qytetit të Lushnjës” dhe rikonstruksioni i rrugës “Rotondo Plukut- Posblloku, rruga e hyrjes Lushnjë-Tiranë”..... 11025
Kërkesë e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7616, datë 16.12.2014	Për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Korçë-Qafë-Plloçë” (shtesa)..... 11026
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Nazmi Gazidedja..... 110027
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Astrit Banushaj..... 110027

**VENDIM****Nr. 889, datë 17.12.2014****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE TË KRITEREVE PËR
SHPËRNDARJEN E FONDIT TË
KOMPENSIMIT TË PRONARËVE, NË
TË HOLLA, PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, shkronja “d” e 17, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është njohur për kompensim, të kompensohen sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri dhe data e vendimit, vetëm nëse vendimi është përfundimtar, i ekzekutueshëm dhe nuk është trajtuar asnjëherë me kompensim.

Në rastet kur vendimi është ndryshuar pjesërisht, për efekt klasifikimi, për njohjen, kthimin dhe kompensimin e asaj prone do të merren për bazë numri dhe data e vendimit më të hershëm në radhë kronologjike.

2. Kompensimi të bëhet vetëm për sipërfaqe deri 200 m², të sipërfaqes truell të caktuar për kompensim, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës, të miratuar sipas vendndodhjes së pronës që kompensohet.

3. Subjektet, të cilat kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2006, 2007, 2008, 2009, 2011, 2012 dhe 2013, dhe që vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit për vitin 2014.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë pranë AKKP-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për kompensim në të holla, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim, dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) titullin për njohjen dhe kompensimin e pronës, që, sipas rastit, mund të jetë vendim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendim i Agjencisë së Kthimit dhe

Kompensimit të Pronave si dhe vendim i gjykatës, në rastet kur vendimet e sipërpërmendura janë ndryshuar në rrugë gjyqësore;

ç) planvendosjen përkatëse, bashkëlidhur vendimit, si dhe planin e rievimit aktual të pronës së njohur për kompensim;

d) dëshminë e trashëgimisë;

dh) prokurë, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë dhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre, në rast se shpallen fitues;

e) dokumentin e identifikimit (letërnjoftim apo pasaportë) të përfaqësuesit të pajisur me prokurë;

ë) mandatpagesën.

5. Në rastin e kërkesave të paraqitura në AKKP, në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 1343, datë 4.6.2008, “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2008”, nr. 487, datë 6.5.2009, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2009”, nr. 192, datë 9.3.2011, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2011”, nr. 768, datë 7.11.2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2012”, dhe nr. 599, datë 17.7.2013, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2013”, të cilat nuk janë realizuar nga AKKP-ja për arsye të ndryshme, kërkuar duhet të pohojnë vullnetin e tyre, nëpërmjet një kërkesë të re për kompensim, të shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 6, të këtij vendimi.

6. Subjektet që kanë aplikuar për kompensimin në të holla në vitet 2008, 2009, 2011, 2012, dhe 2013 duhet të paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën për kompensim financiar, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) dëshminë e trashëgimisë, nëse ka ndryshime në rrethin e trashëgimtarëve të ligjshëm të subjektit



të shpronësuar, sipas radhës së trashëgimtarëve, të përcaktuar në Kodin Civil;

ç) prokurën e posaçme, nëse ajo e paraqitur në vitet 2008, 2009, 2011, 2012 apo 2013 ka kufizimin në kohë për tagrin e tërheqjes së shumës në të holla dhe ndryshimin e rrethit të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar.

7. AKKP-ja shqyrton dokumentacionin e subjekteve që kërkojnë kompensim në të holla, duke kryer veprimet e mëposhtme:

a) verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;

b) kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të konfirmojnë për:

i) regjistrimin e vendimit përkatës në ZVRPP;

ii) përcaktimin e gjendjes juridike aktuale të pronës dhe verifikimin nëse ajo ka ndryshuar nga momenti i daljes së vendimit me të cilin aplikohet;

iii) verifikimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.

c) në rastin kur është e nevojshme, grupi i punës kryen verifikimin në terren të gjendjes së pronës dhe mban procesverbalin përkatës;

ç) përgatit planvendosjen e pronës që kompensohet dhe cakton:

i) në hartën e vlerës, zonën ku ndodhet prona;

ii) në bashkëpunim me subjektin e shpronësuar, pjesën e pronës, që kërkohet për t'u kompensuar, sipas masës që përcaktohet në pikën 2, të këtij vendimi, dhe i kërkon përfaqësuesit me prokurë të nënshkruajë për pjesën që kompensohet.

d) llogarit vlerën e sipërfaqes që kompensohet;

dh) përgatit vlerësimin ligjor ku, për secilin subjekt kërkues, shpjegohen me hollësi:

i) vlefshmëria e vendimit të paraqitur nga kërkuesi;

ii) konfirmimet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

iii) vlerësimi i pronës për kompensim.

e) merr vendimin për pranimin apo refuzimin e

kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar. Për të gjitha kërkesat, me objekt kompensimin në të holla, të vendimeve që nuk përfitojnë kompensim për arsye të pamjaftueshmërisë së fondit të vënë në dispozicion, AKKP-ja do të bëjë lajmërim publik;

ë) u dërgon subjektit të shpronësuar, Avokaturës së Shtetit dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të dhëna, për t'u krijuar mundësi të ushtrojnë kompetencat ligjore;

f) shpall listën e subjekteve fituese;

g) kryen veprimet me thesarin dhe bankën për kalimin e fondit të kompensimit, në të holla, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e buxhetit të shtetit.

8. Procesi i regjistrimit/pranimin të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 1 (një) muaj.

9. Procesi i trajtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar duhet të kryhet në përputhje me këtë vendim dhe me afatin ligjor, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

10. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre nga subjektet e shpronësuar, në zbatim të këtij vendimi, sjell përjashtimin e menjëhershëm të këtyre subjekteve nga procedura e kompensimit, në të holla, dhe i ngarkon ata me përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Formulari tip 1

KËRKESË PËR KOMPENSIMIN E PRONËS

Drejtuar: AGJENCISË SË K'THIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Data e paraqitjes së kërkesës: _____ 2014

Subjekti i shpronësuar:

Emri

Atësia

Mbiemri

Personi me prokurë që paraqet kërkesën:

Emri

Atësia

Mbiemri

Adresa e personit me prokurë:

Qarku

Rrethi

Qyteti/fshati

Lagja

Rruga

Nr. i banesës

Telefon

Celular

e-mail

Kërkoj kompensimin e pronës me të holla, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____ 2014, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve, në të holla për vitin 2014”.

Kërkuesi

(emri, atësia, mbiemri, nënshkrimi)

Shënim. Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedure e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

Formulari tip 2

DEKLARATË

Personi me prokurë që paraqet kërkesën :

Emri

Atësia

Mbiemri

Adresa e personit me prokurë :

Qarku

Rrethi

Qyteti/fshati

Lagja

Rruga

Nr. i banesës

Telefon

Celular

e-mail

Në emër të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, sipas prokurës së posaçme të bashkëlidhur, deklaroj se:

1. Në rast se nuk shpallem fitues, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____ 2014, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve, në të holla për vitin 2014”, tërhiqem nga kërkesa e paraqitur për kompensimin në të holla për vitin 2014.

2. Heq dorë nga e drejta e parablerjes për sipërfaqen e kompensuar, në rast se shpallem fitues në këtë aplikim.

3. Nuk kam përfituar nga kompensimet e mëparshme si në të holla, ashtu dhe fizik me vendimin për njohjen e të drejtës së kompensimit, me të cilin aplikoj.

4. Nuk jam në proces gjyqësor, apo proces shqyrtimi të një ankimi administrativ në lidhje me pronën objekt kompensimi.



5. Deklaroj që të gjithë trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, të cilët përfaqësoj me prokurë, janë gjallë.

Kjo deklaratë i bashkëlidhet kërkesës nr. _____, datë _____ 2014, për kompensim në të holla për vitin 2014.

Deklarues (përfaqësuesi me prokurë)

(emri, atësia, mbiemri, nënshkrimi)

Shënim. Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

UDHËZIM

Nr. 364, datë 16.12.2014

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË
LISTAVE TË ZGJEDHËSVE
PËRZGJEDHJET E ORGANEVE TË
QEVERISJES VENDORE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 49, 50, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të dekretit nr. 8844, datë 15.12.2014 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”,

UDHËZOJ:

1. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në afatet që parashikon ligji dhe janë të vlefshme për t'u shkarkuar *on-line* nga aplikacioni përkatës i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit, Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, ku përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile shkarkon nga ky sistem përbërësit zgjedhorë, për zgjedhësit sipas vendbanimit përkatës, si më poshtë:

- përzgjedh në menunë në të majtë të faqes së RKGJC-së, opsionin “Procesi i regjistrimit”, “Raportime” dhe zgjedh listën.

2. Nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile gjenerohet formati elektronik i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë brenda datës 30.12.2014, i ndarë sipas qendrave të votimit të zgjedhjeve të datës 23.6.2013 për çdo bashki/njësi bashkiake/komunë.

3. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kontrollon raportin ditor, për numrin e zgjedhësve për çdo qendër votimi. Kur vëren në raportin ditor se ka qendra votimi me më pak se 200 zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1 000 zgjedhës, njofton brenda 48 orëve kryetarin e bashkisë/njesisë bashkiake / komunës. Këto lista gjenden në formatin e posaçëm dhe kanë të shkruar në sfond “jo për afishim” e mund të përdoren vetëm për ndarjen, apo bashkimin e qendrave të votimit sipas ligjit, por në asnjë rast nuk mund të përdoren për afishim, apo në faza të tjera të procesit zgjedhor. Gjithashtu në format të posaçëm, është edhe lista e zgjedhësve mbi 100 vjeç në datën e zgjedhjeve. Kjo listë i njoftohet kryetarit të bashkisë/njesisë bashkiake/komunës, për të bërë njoftimin e këtyre shtetasve për arsyen e mospasqyrimin në listën e zgjedhësve. Në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve që e kanë numrin e qendrës së votimit të ndryshëm nga qendrat e votimit që i përkasin kësaj zyre të gjendjes civile.

4. Lista e zgjedhësve është e grupuar sipas zonave të qendrave të votimit. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari i bashkisë/komunës/njesisë bashkiake, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, vendos bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit.

5. Në rastet e qendrave të votimit me fraksion, të cilat kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari vendos ndarjen e tyre duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë dhe jo çdo fraksion veç e veç. Numri i përgjithshëm i



një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj, do të ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 zgjedhës secila.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 200 zgjedhës, kryetari vendos bashkimin e kësaj qendre me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor, shuma e numrit të zgjedhësve, të cilave duhet të jetë më shumë se 200 zgjedhës. Nëse shuma e numrit të zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen është më shumë se 1000 zgjedhës, atëherë kryetari, pas bashkimit të këtyre qendrave, vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, sipas pikës 5 të këtij udhëzimi. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 200 zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël zgjedhësish i bashkohen qendrës me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, do t'i dërgohen në formë shkresore për zbatim zyrës së gjendjes civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe për dijeni prefektit të qarkut përkatës, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile.

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, me marrjen e vendimit të kryetarit, për ndarjen e qendrave të votimit, brenda 24 orëve kryen veprimet e mëposhtme:

a) në menunë majtas zgjedh “administrimi i qendrave të votimit”;

b) zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të ndahet;

c) plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. ____ datë ____ . ____ . 2015 të kryetarit”;

d) shtyp butonin “Ruaj”.

Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mosrealizimit të ndryshimeve, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht kërkesën për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës së votimit bazë. Në rast se kryetari ka vendosur që adresa e qendrës së votimit me fraksion është e ndryshme nga adresa e qendrës së votimit bazë,

përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile korrigjon adresën e qendrës së votimit me fraksion.

9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, me marrjen e vendimit të kryetarit për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit, brenda 24 orëve kryen veprimet si më poshtë:

a) në menunë majtas zgjedh “administrimi i qendrave të votimit”;

b) zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të mbyllet, si dhe numrin e qendrës së votimit pritëse;

c) plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. ____, datë ____ . ____ . 2015 të kryetarit;

d) shtyp butonin “Ruaj”.

Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mosrealizimit të ndryshimeve, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht kërkesën për bashkimin e qendrave të votimit sipas vendimit të kryetarit.

10. Procedura e përshkruar në pikat 4, 5, 6 dhe 7, do të zbatohet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe nga kryetari përkatës, për çdo ekstrakt të përbërësve zgjedhorë.

11. Në rast se kryetari nuk përmbush detyrimet sipas pikës 4, 5, 6 dhe 7, të këtij udhëzimi deri në publikimin e ekstraktit të fundit para publikimit të listës së zgjedhësve, DPGJC-ja kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, të cilat reflektohen në listat e zgjedhësve të datës 21.6.2015.

12. Zyrat e gjendjes civile në bashki /komuna /njësi bashkiake, brenda datës 14.1.2015 printojnë dhe, pasi të firmoset nga kryetari përkatës, publikojnë ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë, me të njëjtat kritere, do të printohen dhe publikohen edhe çdo 30 ditë sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon këto ekstrakte Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe publikon ekstraktet e përbërësve zgjedhorë në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në momentin e publikimit të ekstraktit të radhës, në faqen e internetit fshihet ekstrakti i mëparshëm.



14. Kryetari i bashkisë/komunës/njesisë bashkiake, brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë, bën njoftimin me shkrim të zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e printuar sipas qendrave të votimit brenda territorit të bashkisë/komunës/njesisë bashkiake përkatëse.

Njoftimi për shtetasit do të jetë sipas modelit nr. 1, i cili gjenerohet nga sistemi.

Brenda këtij afati, kryetari njofton edhe shtetasit me moshë mbi 100 vjeç për arsyen e mospërfshirjes së tyre në listë. Njoftimi do të jetë sipas modelit nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

15. Zgjedhësit, të cilët kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka mospërputhje, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme.

16. Të drejtën e kërkesës për përfshirjen në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë dhe rregullimin e qendrës së votimit e kanë dhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç. Këta shtetas do të bëjnë kërkesë për ndryshim të qendrës së votimit nga 8899 (qendër votimi imagjinare e përdorur nga sistemi vetëm për këtë grup zgjedhësish), në qendrën e votimit sipas vendbanimit. Kjo kërkesë realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

17. Krahas ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile do të

pasqyrojë edhe rastet e vendimeve të gjykatës, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve.

18. Çdo zyrë e gjendjes civile në bashki / njësi bashkiake / komunë, më datë 13.5.2015, printon nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe firmos listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon kryetarit.

19. Kryetari miraton dhe firmos listën dhe e dërgon brenda datës 18.05.2015 në të tri formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në KZAZ-të përkatëse.

20. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, i dërgon një kopje të printuar të listës së zgjedhësve Arkivit Qendror të Shtetit.

21. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen kryetarët e bashkive/komunave/njësive bashkiake, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna/njësi bashkiake, si dhe institucionet e tjera shtetërore që parashikohen në Kodin Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MODEL 1

Qarku: _____
Bashkia/ komuna/njësia bashkiake: _____
Numri banesës: _____

Të nderuar,

Z./znj. emri-emri i babait-mbiemri, datëlindja __/__/__, numri rendor në listë: _____

----- Z./Znj.

Emri-emri i babait-mbiemri, datëlindja __/__/__, numri rendor në listë: _____

Z./znj. emri-emri i babait-mbiemri, datëlindja __/__/__, numri rendor në listë: _____

Z./znj. emri-emri i babait-mbiemri, datëlindja __/__/__, numri rendor në listë: _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21.6.2015, jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimi numër _____, me adresë: Shkolla/godina” _____”, rruga “_____”.

KRYETARI

(emër, mbiemër, firma)



MODEL 2

Qarku: _____

Bashkia/ njësia bashkiake/ komuna: _____

Numri banesës: _____

I/e nderuar/a

Z./znj. _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21.6.2015, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si shtetas që keni mbushur moshën 100 vjeç, nuk jeni të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhore të qendrës së votimit.

Sipas nenit 53 të Kodit Zgjedhor, për t’u përfshirë në listën e zgjedhësve, duhet t’i drejtoheni me kërkesë zyrës së gjendjes civile ku jeni i regjistruar.

KRYETARI

(emër, mbiemër, firma)

MODEL 3

KËRKESË

Drejtuar: Bashkisë/ njësisë bashkiake/ komunës,
Zyrës së gjendjes civile: _____

Unë i quajtur _____ banor i bashkisë/njësisë bashkiake/
(emër, atësi, mbiemër)

Komunës _____, pasi mora njoftimin nga kryetari, se nuk jam i përfshirë në listën e zgjedhësve të datës 21.6.2015, kërkoj nga ana juaj, të më shtoni në listën e zgjedhësve të qendrës së votimi nr. _____, aty ku janë të regjistruar edhe pjesëtarët e tjerë të familjes.

Emër, mbiemër

Data: __/__/____

UDHËZIM

Nr. 29, datë 18.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E
APARATEVE TELEVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave dhe drejtori i përgjithshëm i Radio-televizionit Shqiptar

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive është 100 (një qind) lekë, për çdo muaj kalendarik.

2. Tarifa paguhet nga përdoruesit familjarë dhe nga përdorues të tjerë jofamiljarë. Përdoruesit

familjarë paguajnë tarifën vetëm për një marrës televiziv, pavarësisht nga numri i aparateve që kanë në familje. Përdoruesit e tjerë jofamiljarë paguajnë tarifën për çdo aparat televiziv.

3. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) caktohet agjent për mbledhjen e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive. Mbledhja e kësaj tarife bëhet çdo muaj.

4. Faturat tatimore të energjisë elektrike të OSHEE-së kanë në fund, si një zë më vete, tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, sipas udhëzimit të ministrit të Financave për tatimin mbi vlerën e shtuar.

5. Mbi tarifën e shërbimit, të përcaktuar në këtë udhëzim, nuk aplikohet tatimi mbi vlerën e shtuar.

6. Pagesat e tarifës vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike, ku



shënohet “tarifa e paguar për muajin _____, data e pagesës, si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj tarife”.

7. OSHEE-ja, në cilësinë e agentit të mbledhjes së kësaj tarife, është i detyruar:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për agentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga OSHEE nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektrik të deklaratës së plotësuar. OSHEE-ja duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifën.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive:

a) Për përdoruesit familjarë

- Invalidët dhe veteranët e Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë

të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar”, të ndryshuar, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”.

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë zyrës së OSHEE sh.a., në momentin e pagesës së faturës së energjisë elektrike, librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga tarifa. Nëpunësi i zyrës së OSHEE sh.a., mban një kopje të librezës, në të cilët vendoset shënimi “përjashtuar nga tarifa”.

b) Për përdoruesit jofamiljarë:

-përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në bazë të parimit të reciprocitetit;

-bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave;

-faturimi i energjisë elektrike për aktivitete, të tilla si: miniera, ujësjellës, pusët e naftës, furnizimi i antenave të telefonisë celulare, “ndriçimi publik i rrugëve” dhe garazhe të mjeteve lëvizëse;

-në rastet kur palë në kontratën e konsumit të energjisë elektrike është një subjekt që operon në sektorin e ndërtimit, tarifa llogaritet dhe paguhet nga momenti i kalimit të kontratës në emër dhe për llogari të personit fizik, juridik apo individit pronar i ambientit për të cilin faturuhet energjia.

9. Institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i përcjellin kompanisë OSHEE, brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse, nëse ka.

10. Për shërbimin e kryer, OSHEE-ja mban 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 90% e shumës së arkëtuar.

OSHEE-ja vetëlogarit shumën që përfiton nga komisioni, duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimit nga tarifën për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti



vlerën e komisionit që përfiton, si dhe deklarën dhe paguan në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

11. Udhëzimi nr. 1, datë 8.1.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, i ndryshuar, shfuqizohet.

12. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Shkëlqim Cani

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Martin Leka

**SHTOJCA NR. 1 : INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT
MBI KATEGORITË E PËRJASHTUARA**

Përshkrimi i kategorive	Institucionet përgjegjëse për dhëniën e informacionit mbi kategoritë e përjashtuara
Të verbrit/ paraplegjikë/tetraplegjikë	Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH).
Veteranë lufte	Ministria e Mbrojtjes.
Invalid pune	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH).
Përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë në bazë të parimit të reciprocitetit, ambasadat	Ministria e Punëve të Jashtme
Bashkësitë fetare	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, Komuniteti Shtetëror për Kultet.
